



LIRIKA SHQIPTARE DHE BOTERORE

100 POETE PER
DASHURINE

Përg. KOLEC TRABOINI
ROLAND LUSHI

GJEKE MARINAJ

TË GJITHA JURITË DO MË FALNIN

Në Gjoks

Mban dy kambana të arta të kthjera përmbys,

Por nuk është një kishë e bekuar.

Çuditërisht,

Kur kaloj pranë saj fshehurazi bëj kryq,

Por nuk është besimi ai që m' i komandon duart.

Ndonëse

Helena dhe Circia janë të Shkrira brenda saj,

Ajo nuk është greke.

I vetëdijshëm

Se çdo shikim i saj edhe më thellë më zhyt në
mëkat,

Zotit, këtej e tutje, nuk i kërkoj parajsë tjetër.

